



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ

Data \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT: Rikonstruksion i ambjentit të brendshëm Pallati i Kulturës  
“Artan Cuku” Kamëz.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45210000-  
2**

- *Punime ndërtimi*

**VLERA E FONDIT LIMIT: 74,521,893.33 (shtatëdhjetë e katër milionë e pesëqind e njëzet e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.**

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kamëz** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetin financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të **3 (tre)** viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

**Shënim:** Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 e Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; si dhe Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

### **2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **37,260,946.66** (tridhjetë e shtatë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **149,043,786.66** (njëqind e dyzet e nëntë milionë e dyzet e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

**Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

**Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:**

**- Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:**

- a) Kontratën e Sipërmarrjes,
- b) Situacionin përfundimtar të objektit
- c) Aktin e Kolaudimit të objektit
- d) Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer)
- e) Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar të punimeve.

*Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

**- Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:**

- a) Kontratën e Sipërmarrjes,
- b) Situacionin përfundimtar të objektit
- c) Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d) Aktin e Kolaudimit të objektit

## **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e sukseshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontratën e bashkimit të operatorëve të deklaruar në fazën e tenderimit;
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratë bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

***Argumentimi:** Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.*

*AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.*

*AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.*

**2.3.2** Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të vlefshme të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

### **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :**

- **N.P-1 A** Punime gjurmimi në tokë
- **N.P-2 A** Ndërtime Civile dhe Industriale;
- **N.P-3 B** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada;
- **NP-7 A** Ujësjiellësa, gazjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje;
- **NP-11 A** Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm

dhe shpërndarjen e energjisë

**Për punimet speciale të ndërtimit :**

- **N.S-1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **N.S-4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrë teknike ndërtuese
- **N.S-8 A** Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
- **N.S-12 A** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit
- **N.S-14 A** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj
- **N.S-18 A** Punime topogjeodezike.

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, nr. 42, datë 16.01.2008 (i ndryshuar). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s'kualifikues.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Neni 39, pika 6/a, e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.*

**N.P-1 A Punime gjurmimi në tokë:** *Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjurmimi në tokë konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore. Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime transport materiale ndërtimi, dheu deri 10km. Të tilla punime*

*përfshihen në zërat e punimeve të “punime dheu”. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.*

**N.P-2 A Ndërtime civile dhe industriale:** Me punime të tilla, referuar VKM nr.42 të datës 16.01.2008 konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse. Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Ndërhyrjet objekt kontrate, parashikojnë shtresa betoni dhe mur me tulla te lehtësuara, mure gipsi Në total vlerat për realizimin e strukturave te nevojshme që lidhen me objektin i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë A sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar.

**N.P - 3 B Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash**  
*Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Këto punime janë parashikuar në preventiv. Për zbatimin e punimeve të tilla është e nevojshme që të anagzohen subjekte të specializuar, të cilët zotërojnë licensën N.P – 3. Kategoria C i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit*

**N.P - 7 A Ujësjetës, gazsjellës, vajsjetës, vepra kullimi e vaditje**  
*Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjetësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura. Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Sic jane : F.V. Grup per furnizimin me uje nga rrjeti i qytetit e kompletuar me reduktor presioni, mates per sasine e ujit, kundralvul, filter dhe saraçineska, F.V Tuba e rakorderi ujesjetlesi , F.V tub kanalizimi, puseta shkarkimi etj. Per sa me siper ne total vlerat për realizimin dhe kompletimin me strukturat e nevojshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë A sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar.*

**NP-11 A** *Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë:* Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me spostime shtylla elektrike perfshire dhe linjat, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine NP-11A, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

**N.S - 4 A** *Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.*

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar me punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Vendosja e këtij kriteri u referohet punimeve të parashikuara në projektet teknikë, relacionet teknikë, specifikimet, preventivin dhe grafikun e punimeve për zbatimin e veprës. Këto punime parqiten të detajuara në projektin arkitekturor dhe specifikimet e punimeve ndërtimore. Punimet e parashikuara në këtë dokumentacion teknik përfshijnë punime suvatimi, punime dyersh dhe dritaresh, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme, punimeve shtresash me pllaka dhe parket dhe punime të ndryshme izolimi. Vëllimi dhe vlerat e punimeve të tilla janë të konsiderueshme. Tipologjia e mureve, veshjeve, rifiniturave, dyerve dhe dritareve në objekt është e larmishme. Për zbatimin e punimeve të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, përcakton se duhet të disponohet licenca NS-4.

Nga sa më sipër, duke marrë në analizë të gjithë dokumentacionin teknik, specifikën e punimeve dhe vlerat e të gjithë punimeve të tilla në preventivin total të kësaj ndërhyrjeje, u vendos si kriter teknik profesional licenca NS-4 A, e cila është e domosdoshme për vlerën, rëndësinë dhe kompleksitetin e punimeve të tilla.

**N.S - 8 A** *Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri*

Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur.

b. Struktura metalike. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Vendosja e këtij kriteri u referohet punimeve të parashikuara në projektet teknikë, relacionet teknikë, specifikimet, preventivin dhe grafikun e punimeve për zbatimin e veprës. Këto punime parqiten të detajuara në projektin strukturor. Punimet e parashikuara në këtë dokumentacion teknik përfshijnë ndërtimin e konstruksionit metalik te perbera per skenen per vendosjen e ndriçuesve dhe paisjeve tetjera qe nevojiten ne skene. Për zbatimin e punimeve të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, përcakton se duhet të disponohet licenca NS-8.

Nga sa më sipër, duke marrë në analizë të gjithë dokumentacionin teknik, specifikën e punimeve dhe vlerat e të gjithë punimeve të tilla në preventivin total të kësaj ndërhyrjeje, u vendos si kriter teknik profesional licenca NS-8. Kategorija A i referohet vlerës së këtyre punimeve në preventivin

*total dhe përcaktimeve të VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.*

***N.S- 12 A    Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.***

*Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.*

*Referuar VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin, Ndarjen, Bashkimin ose Mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të Degëve të tyre”, Pika 2.c.) Standarde dhe normativa për infrastrukturën e IAL-së, paragrafi ë):*

*ë) Mjediset e IAL-ve duhet të jenë të pajisura me sisteme funksionuese ngrohje-ftohjeje.*

*Objekti i parashikuar të rikonstruohet do të pajiset me sistem të plotë HVAC. Sistemi i propozuar në projektin HVAC është konceptuar posaçërisht për funksionin e ndërtesës si objekt i kulturor. Impianti i projektuar nëpërmjet këtij projekti është parashikuar - Impiant hidrik primar me prurje variabël dhe sekondar me prurje variable. Komforti termik, qarkullimi i mirë i ajrit dhe lagështia relative e krijuar në ambient është shumë e rëndësishme në objektet e kësaj natyre. Në projektin mekanik HVAC, duke përfshirë zgjidhjet grafike, relacionin teknik, specifikimet teknike, si dhe pjesën përkatëse të preventivit dhe grafikut të punimeve për realizimin e secilit seksion të ndërtesës janë parashikuar të gjitha punimet për ndërtimin e rrjeteve, furnizimin dhe montimin e këtij sistemi. Për realizimin e këtyre punimeve në kriteret teknike është kërkuar që OE të zotërojë kapacitetet teknike profesionale për zbatimin e sistemit të plotë të ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit, në përputhje me zgjidhjet teknike të hartuara nga projektuesi. Vendosija e këtij kriteri kushtëzohet nga punimet e parashikuara të realizohen për kompletimin dhe përmbylljen e veprës. Nisur nga natyra e punimeve dhe vlerat e preventivit për zbatimin e tyre, është e domosdoshme që OE të jetë i pajisur me licensën respektive N.S- 12 A, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.*

***N.S- 14 A    Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.***

*Me impiante të kësaj tiplogjie, në shtjellim të N.S – 14 konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

*Projekti i zbatimit parashikon ndër të tjera zbatimin e punimeve për rrjetet elektrike dhe elektronike, të tilla si punimet për instalimin e rrjetit elektrik të furnizimit me energji, rrjetin e tokëzimit dhe rrufepritjes, ndriçimin, rrjetin lan ,etj pajisje sistemi i zbulimit dhe lajmërimit të zjarrit.*

*Punime të tilla duhet të realizohen nga subjekte të kualifikuara për realizimin e tyre, në përputhje me VKM nr.42 të datës 16.01.2008, më sipër cituar. Licensa e nevojshme për realizimin e këtyre punimeve, referuar këtij akti është N.S- 14 - Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV. Kategoria A i referohet vlerës së punimeve të tilla në preventivin e punimeve.*

***N.S- 18 A    Punime topogjeodezike.***

*Punime të tilla përfshijnë zbatimin e rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh. Sikurse shtjellohet në specifikimet teknike të punimeve ndërtimore, mbështetur në dokumentacionin topografik të hartuar nga projektuesi dhe*

*dokumentacionin e pronësisë së objektit, çdo shërbim tjetër topografik, të nevojshëm për zbatimin e saktë të projektit.*

*Objekti i parashikuar të rikonstruohet ka një planimetri me formë të thyer, planimetritë e tij zhvillohen në disa nivele dhe disnivele, volumetria është komplekse dhe zbatimi jo i saktë i të projektit në të gjitha nivelet mund të çojë në dëme kolosale dhe pamundësi teknike për realizimin e duhur të këtij konstruksioni. Kategoria A i referohet vlerës totale të punimeve për riaftësimin e territorit dhe zbutjen e efekteve negative në preventivin e projektit të zbatimit. Kriteri në fjalë, është një kërkesë e domosdoshme në përputhje të plotë me projektin, preventivin dhe specifkimet teknike dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ushtron veprimtarinë e vetë në fushën e ndërtimit dhe ka kapacitetet teknike të nevojshme për zbatimin e kontrates. Kjo është një kërkesë minimale në përpjestim me vlerën dhe rëndësinë e kontratës që prokurohet, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, dhe që ka për qëllim të provojë se operatori ekonomik ka kapacitetet teknike për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.*

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<i>Kategori a e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit të kërkuar për kategorinë e respektive</i>
N.P-1 A	Punime gërmimi në tokë	Transport mbeturinash, nga prishje te brendshme te godines, me krahë Transport dheu me auto, deri 10.0 km	0-20 mln leke
N.P-2 A	Ndertime civile dhe industriale	Mur të lehtësuara sipas	0-20 mln leke
N.P-3 A	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash	Vetrato xhami i temperuar Dyer dritare	0-20 mln leke
N.P-7 A	Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje	F.V. Grup per furnizimin me uje nga rrjeti i qytetit e kompletuar me reduktor presioni, mates per sasine e ujit, kundralvul, filter dhe saraçineska; Me diameter DN 50 mm, 70mm Sipas zërave të preventivit	0-20 mln leke
N.P-11 A	Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elekt	Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike Sipas zërave të preventivit	0-20 mln leke
N.S- 1. A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Punime për prishjen e ndërtimeve Sipas zërave të preventivit	0-20 mln leke
N.S- 2. A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre Sipas zërave të preventivit	0-20 mln leke

### 2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga QKB me Kodin III.2.B - Grumbullim dhe transport i mbetjeve të Ngurta, së bashku me aktin e miratimit

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.*

**Argumentimi:** *Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”. Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.*

*Ne Ligjin nr. 57 /2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 68, pika 2 dhe 3 parashikohet se: “2. Grumbullimi, transportimi, ruajtja, riciklimi, përpunimi, asgjësimi, tregtimi apo ndërmjetësimi për mbetjet kryhen nga persona që disponojnë licencën për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, me kodin III.2.B, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë. 3. Licenca për veprimtaritë e parashikuara në pikën 2 të këtij neni lëshohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore nga “Qendra Kombëtare e Biznesit”, pas miratimit të saj nga ministri”.*

*Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.*

*Kërkesa që operatori ekonomik të jetë i licensuar me Kodin III.2.B është e nevojshme sepse gjatë ndërtimit të rrugës krijohen mbetje ndërtimore që duhet të menaxhohen në mënyrë ligjore dhe të kontrolluar.*

*Kodet e kërkuara lidhen specifikisht me zërat e punimeve, si punime gërmimi, prishje, pastrimi i pusetave dhe mbingritjen e tyre, zëra të cilat shkaktojnë mbetje. Kjo garanton që operatori ekonomik mund të grumbullojë dhe transportojë ligjërisht mbetjet e ngurta të rrugës, duke përfshirë metalet e tabelave, betonin, tullat dhe mbeturinat e tjera të kantierit, duke siguruar siguri mjedisore dhe respektim të rregullave ligjore.*

*Kjo licencë garanton që operatori: respekton legjislacionin mjedisor; transporton dhe depoziton mbetjet në mënyrë të rregullt; shmang ndotjen dhe problemet për komunitetin dhe siguron organizim e siguri më të mirë në kantier.*

**2.3.4** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi **per muajin e fundit** të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- **1 (një) Inxhinier Ndertimi**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **1 (një) Inxhinier Elektrik**
- **1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**

-Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt sipas Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

-Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Drejtuesit Teknik të mesiperm janë të punësuar në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Per drejtuesit Teknik të kerkuar të paraqitet:

- i. Libreze pune (përkatëse)
- ii. C.V (përkatëse)
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- iv. Diplomë

(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të plotësojë pikat dhe deklaratat e mesiperm në varesi të vlerës dhe zerave të preventivit të punimeve që ka marrë persipër sipas përqindjes së bashkepunimit).

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit dhe deklaratave të mesiperm, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

**Shenim :** Në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për inxhinieret e mesiperm, emer/mbiemer, atesia, numrin personal të ID , numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka leshuar këto dokument.

**Argumentim:** Autoriteti Kontraktor këto kritere i ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6.

Keto kritere i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu bindur se OE zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Këtu nga AK janë përcaktuar kriteret e nevojshme për personelin e kualifikuar sipas niveleve të ndryshme të kualifikimit dhe profileve të nevojshme mbështetur në tipologjinë e punimeve, si dhe kërkesat për fuqi punëtore referuar përmasave dhe natyrës së kontratës, objekt prokurimi.

**Inxhinieri i Ndërtimit**-është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit si dhe për sigurimin teknik në proceset e punës. Ky inxhinier ka për qëllim menaxhimin e zbatimit të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimi apo rikonstruksioni, ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier;

Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe zbatimi i punimeve strukturore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndekur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standardet dhe kriteret e zbatimit nga ekspert inxhinier ndërtimi. Ndjekja e të gjithë procesit ndërtimor që në fazën e pastrimit të sheshit, punimet e ngritjes së kantierit, skelerive, objekteve ndihmëse, punimet e muraturës, punimet e shtresave izoluese, realizimi i daljeve për sistemet teknike të ndërtesës realizimi i strukturës mbajtëse, punimet e përforcimit strukturor, punimet për realizimin e konstruksioneve metalike të thjeshta dhe të përbëra janë punime të parashikuara në projektet e punimeve ndërtimore dhe në preventvin respektiv. Për ndjekjen e punimeve të përgjithshme ndërtimore do të ishte e nevojshme që të angazhoheshin dy inxhinierë ndërtimi. Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar angazhimi i të paktën dy ekspertëve inxhinierë ndërtimi. Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe mos rëndimin e OE nga AK është kërkuar që detyrimisht të jetë në licensën e shoqërisë të paktën nje inxhinier ndertimi. Inxhinieri i dyte i licensuar i nevojshëm jo domosdoshmerisht të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë.

-Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e prishjes, punimet e gërmimit, punimet e shtresave, punimet e muraturës, suvatimet, hidroizolimet, sistemimet e jeshme etj. Punimet ndërtimore përbëjnë pjesën më të madhe të vëllimit të punëve për zbatimin e projektit, sikurse edhe ato më komplekset.

Punimet e ndërtimit duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit. Respektimi i kërkesave për qëndrueshmëri strukturore dhe qëndrueshmëri, plotësimi i kërkesave për mbrojtjen pasive nga zjarri, përdorimi i materialeve që nuk janë të dëmshëm për jetën dhe shëndetit e përdoruesve të ambienteve dhe saktësia në realizimin e të gjithë elementëve konstruktivë sjellin

domosdoshmërinë që çdo element dhe hallkë e zbatimit të këtyre punimeve të ndiqet dhe udhëhiqet nga ekspertë të licensuar të fushës.

**Inxhinieri Hidroteknik-** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar zerave hidroteknike, etj.

**Inxhinieri Elektrik-** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar zerave elektrike, etj

-Punimet elektrike përfshijnë zëra me vlera të konsiderueshme në prevetivin total të punimeve. Zërat e përfshirë në preventiv shoqërohen me zgjidhet teknike të hartuara nga eksperti inxhinier elektrik në projekt, në relacionin teknik dhe specifikimet teknike. Të tilla punime janë punimet për kuadrot elektrike, sistemin e fuqisë dhe ndriçimit, sistemi i mbrotjtes nga shkarkimet atmosferike dhe tokëzimi, tokëzimi i përsëritur te kuadri kryesor i godinës. Për këtë arsye, lind nevoja që për zbatimin e punimeve në të gjitha vëllimet e objektit të angazhohen minimalisht nje inxhinier elektrik i licensuar i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë. Kërkesa e AK lidhur me inxhinierin elektrik eshte kufizuar në minimalisht një drejtues teknik të shoqërisë, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes.

**Inxhinieri Gjeodet/ Topograf/ Markshajder** është përgjegjës për dhe do të kryejë azhornimin topografik dhe piketimin e objektit ndërtimor, si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bejë edhe azhornimin faktit (as built). Ky inxhinier është i nevojshem për dhënien në terren të kuotave të nevojshme mbi dhe nën tokësore gjatë zbatimit të punimeve të objektit deri në përfundimin e plotë të tij në përputhje me kuotat e përcaktuara në projektin e zbatimit të objektit.

**2.3.5** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- **Arkitekt** - **1 (një)**
- **Inxhinier Mekanik** - **1 (një)**
- **Inxhinier Elektronik** - **1 (një)**

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **për muajin e fundit** te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, C.V.

Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa përpara lidhjes/nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë për personelin inxhinier të sipërcituar dokumentacion e lart përmendur.

**Argumentim:** Autoriteti Kontraktor këto kritere i ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6.

*Keto kritere i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu bindur se OE zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Këtu nga AK janë përcaktuar kriteret e nevojshme për personelin e kualifikuar sipas niveleve të ndryshme të kualifikimit dhe profileve të nevojshme mbështetur në tipologjinë e punimeve, si dhe kërkesat për fuqi punëtore referuar përmasave dhe natyrës së kontratës, objekt prokurimi.*

*Në kërkesat për personelin e kualifikuar nga AK janë kërkuar disa kategori personeli, të domosdoshëm për të kryer të gjitha shërbimet e nevojshme dhe mbulimin e të gjitha hallkave/etapave të zbatimit të projektit, sipas nivelit të kompetencave profesionale deri në realizimin e plotë të veprës.*

*Në kërkesat për personelin e kualifikuar janë kërkuar ekspertët arkitektë dhe inxhinierë të licensuar, sipas profileve të domosdoshme për të mbuluar të gjitha punimet e parashikuara në projekt – zbatimin e parashikuar të relizohet nëpërmjet kësaj kontrate. Një pjesë e këtyre ekspertëve duhet të jenë të përfshirë në licensën e shoqërisë, ndërsa pjesa tjetër jo domosdoshmerisht të përfshirë në licensën e shoqërisë, por me kontrate pune.*

**Arkitekt-** *Projekti arkitekturor duhet të zbatohet në përputhje me konceptin e përgjithshëm arkitekturor të projektit të zbatimit të hartuar nga **projektuesi arkitekt**. Zërat e punimeve që përfshin ky projekt permbajnë ndër të tjera punime të rifiniturave, punimet e dyerve, dritareve dhe fasadave etj. Këta zëra punimesh u nështrohen kërkesave të projektit arkitekturor të zbatimit, kërkesave estetike, higjieno – sanitare, funksionale të specifikuara në këtë projekt. Konceptimi i brendshëm hapsinor duhet të respektojë rigorozisht zgjidhjet teknike të hartuara nga projektuesi arkitekt. Zgjidhjet planimetrike – hapsinore të projektit në fjalë janë relativisht komplekse. Është e rëndësishme që në vëllimet që ndërtohen të vendoset për përdorimin e materialeve në ndërtesë, ngjyrave të ndryshme të materialeve, duke i shërbyer anës estetike, ekuilibrit të ndërtesës në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi. Në përputhje me specifikimet teknike të punimeve ndërtimore, që shoqërojnë projektin arkitekturor, punë të caktuara duhet të projektohen dhe instalohen nga ekspertë të veçantë. Këtu përfshihen të gjitha fasadat e xhamit dhe instalimet e dritareve përfshirë pusët e dritës, të gjitha punimet dhe strukturat metalike, të gjitha dyert e veçanta (p.sh.: dyert anti-zjarr apo të sigurisë), të gjithë elementët e mobiljeve urbane që janë*

*prodhuar dhe montuar enkas, të gjithë elementet e detajuar të infrastrukturës urbane (kapakët e pusetave, kapakët e kanaleve të kullimit, etj.*

*-Për zbatimin e saktë të projektit të zbatimit arkitekturor, i cili sikurse është shtjelluar më sipër është kërkuar angazhimi i nje arkitekti të licensuar i cili të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë.*

***Inxhinier Mekanik-*** *Projekti që do të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure prokurimi përmban si komponent të tij edhe projektin HVAC. Ky projekt përmban zgjidhjet grafike, relacionin teknik, specifikimet teknike dhe preventivin e realizimit të punimeve të tilla. Realizimi i këtij projekti për të gjithë vëllimet e objektit është shumë i rëndësishëm për sigurimin e komfortit termik në ambiente. Sikurse shtjellohet në realcionin teknik përkatës, parametrat projektuese të projektit janë marrë në përputhje me tipin dhe destinacionin e objektit dhe ambienteve të veçanta të tij. Sigurimi i një komforti termik të përshtatur për secilin ambient duke veçuar tipologjitë e veçanta funksionale është domosdoshmëri. Nisur nga vëllimi i madh i punimeve, sjell nevojën që minimalisht të angazhohen në zbatimin e punimeve **inxhinieri mekanikë** të licensuar. Vëllimi i madh i punës mund të përballohet duke parashikuar edhe një inxhinier mekanik.*

***Inxhinier Elektronik*** - *-Ndër sistemet teknike, të parashikuara në projektin e zbatimit për kompletimin e veprës, është janë edhe rrjetet elektronike të ndërtesës. Këtu përfshihen rrjeti lan, sistemi i zbulimit dhe lajmërimit të zjarrit. Për zbatimin e këtyre punimeve, nisur nga vëllimi relativisht i ulët i punimeve krahas me punimet për sistemet e tjerë është kërkuar angazhimi i një inxhinieri elektronik, i cili duhet minimalisht të jetë diplomuar në teknologji informacioni. Inxhinieri elektronik jo domasdoshtmerisht duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë.*

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

a) **1 (një)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, duhet të jenë të pajisur me çertifikatën e Trajnimit për **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Punë”**, e lëshuar nga një organizëm i licensuar certifikimi shqiptar ose i huaj, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi **për muajin e fundit** të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

**Shënim:** *Për kriterin si më sipër, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit*

**Argumentimi:** *AK argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, i ndryshuar sipas të cilit: “1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të*

*sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion”.*

*Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.*

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar minimumi **35 (tridhjetë e pesë)** punonjës të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listpagesat perkatese të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

**Argumentimi:** *Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën.*

*Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje **per muajin e fundit**, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave j, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.*

*Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën **35 persona** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.*

*Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Analizat teknike jane bazuar ne VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” .Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos(material, puntori, makineri, transport).*

*Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.*

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si dhe të përfshirë në listepagesa **për periudhën e muajit të fundit**, me profesionet si më poshtë:

- 1 (një) Teknik ndërtimi
- 1 (një) Specialist IT
- 2 (dy) punonjës hidraulik
- 2 (dy) punonjës elektrikist
- 2 (dy) punonjës bojaxhi
- 1 (një) punonjës murator
- 2 (dy) punonjës suvatues
- 1 (një) punonjës hidroizolues
- 2 (dy) punonjës për punime durale
- 2 (dy) punonjës për punime gipsi
- 2 (dy) punonjës pllakashtrues
- 1 (një) punonjës shtrues parketi
- 2 (dy) punonjës specialist për ngrohje-ftohje
- 1 (një) punonjës specialist për konstruksione metalike
- 1 (një) punonjës saldator
- 1 (dy) punonjes mobiliere

Krahas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

<b>nr.</b>	<b>emër mbiemër i punonjësit</b>	<b>profesioni</b>	<b>institucioni public/privat lëshues i certifikatës/diplomës</b>	<b>nr. i certifikatës/diplomës</b>	<b>nr nipt (në rast se lëshuesi është institucion privat)</b>
<b>1.</b>					
<b>2.</b>					
<b>etj.</b>					

**Shënim:** Disponimi i stafit/punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në dst, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: **për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, dëshmi/certifikatë kualifikimi ose cdo dokument tjetër që vërteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme.**

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma "c".

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme). Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë".

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve:**

**-Teknik ndërtimi** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.

**-Elektrici** -Për zbatimin e punimeve elektrike dhe elektronike, të tilla si punimet për kuadrot elektrike, sistemin e fuqisë dhe ndriçimit, sistemi i mbrotjes nga shkarkimet atmosferike dhe tokëzimi, tokëzimi i përsëritur te kuadri kryesor i godinës, punimet për motimin e gjeneratorit dhe transformatoreve, si dhe punimet për lidhjen e rrjeteve me infrastrukturën publike është kërkuar që sipërmarrësi të ketë të punësuar të paktën 2 (dy) elektrici. Këta punëtorë të kualifikuar, referuar Listës Shqiptare të Profesioneve merren me ndërtim, montim, instalim dhe riparim të sistemit elektrik në ndërtesa të ndryshme civile, objekteve social kulturore apo industriale etj. Elektrici monton, instalon, riparon dhe mirëmban makineri dhe pajisjeve elektrike civile dhe industriale. Punimet elektrike zënë një vend të rëndësishëm në preventivin total të punimeve, si nga

pikëpamja e sasisë, ashtu edhe të vlerave, pra për këto rast kerkohen 2 specialiste elektriciste Kjo është një kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e madh të punimeve.

**-Ndersa për zbatimin e punimeve elektronike nga AK është kërkuar që OE të kenë të punësuar minimalisht 1 (nje) specialist IT/ elektronik.** Ky punëtor i kualifikuar, referuar Listës Shqiptare të Profesioneve merren punimet për instalimin e rrjetit lan dhe telefonisë, sistemin e zbulimit dhe lajmërimit të zjarrit, sistemin audio për sallat e leksioneve, sistemin CCTV, sistemin e sigurisë dhe kontrollit të hyrje – daljeve. Punimet elektronike dhe vëllimi i tyre përshkruhen në pikat përkatëse të projektit. Kërkesa për **1 (nje) specialist IT** është një kërkesë tepër minimale.

**-Hidraulik-** Për realizimin e punimeve hidraulike në objekt janë kërkuar **2 (dy) punonjës hidraulikë.** Punonjësi hidraulik sipas Listës Shqiptare të Profesioneve merret me ndërtime, montime, instalime, riparime dhe mirëmbajtje të sistemit hidraulik, të sistemit të ujësjellës kanalizimeve, të sistemit të ujitjes, sistemeve të ngrohje-ftohjes, të sistemeve hidraulike të objekteve të prodhimit industrial dhe objekte të tjera që përdorin sisteme hidraulike të ngjashme. Ai monton, instalon, riparon dhe mirëmban pajisjet dhe aksesoret për ujë, gaz, kullim, kanalizim, pajisje të sistemeve të ngrohje-ftohjes, pajisje pneumatike etj. Projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure parashikon punime për montimin dhe instalimin e rrjeteve dhe pajisjeve të furnizimit me ujë dhe shkarkimeve, si dhe pajisjeve të ngrohje-ftohjes. Konkretisht për kryerjen e punimeve për zërat e punimeve hidraulike kerkohen 2 specialiste hidraulik. Kjo është një kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e punimeve

**-Bojaxhi -** Për punimet e bojatisjeve të brendshme dhe të jashtme të të gjithë mureve dhe tavanëve AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar minimalisht **2 (dy) bojaxhinj.**

**-Suvatues -**Punimet e muraturës në objektin që ndërtohet parashikojnë ndërtimin e murit në vëllimet që rikonstruktohen, duke qenë se hapsirat e brendshme në vëllimin që rikonstruktohen do të rikonceptohen tërësisht. Muratorët, sipas Listës Shqiptare të Profesioneve, realizojnë detyra të tilla si: Përzgjedhin materialet e nevojshme dhe veglat e punës para fillimit të procesit të punës, respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, duke respektuar porcionet e duhura të materialeve përbërëse, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt, kontrollojnë nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre, ndërtojnë soletat, vendosin arkitrarët e dyerve dhe dritareve, vendosin kondrakasat e dyerve dhe dritareve, nëse ka të tilla të parashikuara në projekt, bëjnë mbushjen me llac të mureve në nivelin e fashove me dorë ose me pompë në varësi të materialit të përcaktuar nga drejtuesi teknik në objekt, përgatitin materialin e nevojshëm për tavane me gips apo për tavane të varura zburues duke bërë matjet dhe prerjet e duhura, bëjnë stukime apo riparimet e duhura të objekteve të ndryshme, bëjnë kontrollin përfundimtar të punimeve, duke u siguruar që gjithçka është sipas përshkrimit në projekt etj. Konkretisht për realizimin e zërit murator/suvatues është e domosdoshme prania **2 (dy) suvatues dhe një muratori**

**-Hidroizolues-**Projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër të tjera realizimin e punimeve të hidroizilimit. Këtu përfshihen të gjitha punimet dhe shtresat e lidhura me hidroizilimin për ambientet në kontakte me ujin. Për realizimin e punimeve të tilla në të gjithë vëllimet e objektit, në të cilët do të punohet, kërkesa që OE të ketë të punësuar të paktën 1 (një) hidroizolues është kërkesë minimale në raport me vëllimin e punës.

**-Specialiste punime durale -**Për punimet e dritareve dhe dyerve nga Ak është kërkuar që të punësuar një numër minimal prej **2 (dy) punonjës për punime durale.** Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Projekti i parashikuar të zbatohet nëpërmjet

kësaj procedure parashikon realizime te punimeve te vendosjeve te dyerve te brendshme, dyerve te blinduara, vetratave etj. Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve, per kete rast kerkohen 2 specialiste punime durale. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e punimeve.

**-Punonjës punime gipsi** -Për punimet e gipsit nga Ak është kërkuar që të punësuar një numër minimal prej **2 (dy) specialiste per punime gipsi**. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Projekti i parashikuar të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure parashikon realizime te punimeve te ndertimit te mureve dhe tavaneve me kartonxhes etj. Konkretisht duhet te jene teknike te specializuar pra per kete rast kerkohen 2 specialiste punime gipsi. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e madh të punës.

**-Pllakashtrues dhe shtrues parketi** -Referuar Listës Shqiptare të Profesioneve, shtruesi i pllakave (pllaka shtruesi) dhe të tjerë që lidhen me to instalon, mirëmban dhe riparon parkete dhe lloje të tjera të dyshemeve ose mbulojnë dyshemetë, muret ose sipërfaqet e tjera me pllaka ose panele mozaikësh për qëllime dekorimi ose të tjera. Punimet e parashikuara në këtë projekt parashikojnë shtrimin e të gjitha dyshemeve të kateve, shtrimin e sipërfaqeve të shkelhme të shkallëve, shtrimin me pllaka të mureve të tualeteve etj. Këto punime në preventiv pëfshijnë sipërfaqe të mëdha. Për realizimin e tyre AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar një numër minimal prej **2 (dy) pllakashtruesish dhe 1 (nje) shtrues parket/laminati**.

**-Specialiste punime ngrohje-ftohje** - Për zbatimin e punimeve për instalimin e kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse në të gjithë vëllimet e objektit që do të ndërtohet nga AK është kërkuar që të angazhohen minimalisht 2 (dy) instaluesë të sistemeve ngrohëse – ftohëse. Sipas Listës Shqiptare të Profesioneve, instaluesi dhe riparuesi i kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse merret me parapërgatitjen, montimin dhe instalimin e kondicionerëve, kaldajave, paneleve diellore, çillërave (sistemeve ngrohëse-ftohëse), si dhe kryen riparime apo punime mirëmbajtjeje në sistemet e ngrohje- ftohjes. Referuar preventivit të punimeve janë shume pajisje për tu montuar, pa llogaritur pajisjet e vogla, tubat dhe rakorderitë. Konkretisht per kryerjen e punimeve per zerat e punimeve për instalimin e kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse kërkesa për 2 (dy) instaluesë të sistemeve ngrohëse – ftohëse në total për të gjithë vëllimet e objektit është kërkesë minimale në raport me vëllimin e madh të punës

**-Specialist per konstruksionet metalike** - është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve te konstruksioneve metalike ne objekt, sipas zërave te punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin Kërkesa që OE të ketë të punësuar minimalisht 1 (nje) specialist per konstruksionet metalike, është kërkesë minimale në raport me vëllimin e punimeve.

**-Saldatori** -Për saldimin e elementëve metalikë nga Ak është kërkuar që të punësuar një numër minimal prej 1 (nje) saldator. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Projekti i parashikuar të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure parashikon realizime te strukturave metalike. Konkretisht per kryerjen e ketyre punimeve eshte e domosdoshme prania e 1 (nje) saldatori.

**- Punonjes mobiliere-** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve te mobilimit ne objekt, sipas zërave te punimeve, në përputhje me projektin dhe preventivin Kërkesa që OE të ketë të punësuar minimalisht 1 (një) punonjës mobiliere, është kërkesë minimale në raport me vëllimin e punimeve.

**Shënim:** Prezenca e këtyre punonjësve në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

**2.3.9** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:

- 2 (dy) shoferë kamioni;

- 1 (një) automakinistë (drejtues **autovinçi**, autobetoniere, autopompa betoni, autobitumatriçe)

Për realizimin e punimeve ndërtimore për zbatimin e projektit, janë parashikuar këto makineri mbi bazë automjeti:

Për manovrimin e autovinç, nje autobetoniere, nje autopompe betoni dhe një vinç me kosh, Për manovrimin e të cilave eshte kërkuar **1 (nje) automakinist**. Ky numër automakinistësh është kërkuar minimal në raport me nevojat, duke patur për qëllim rritjen e pjesëmarrjes. Proceset e lidhura me këto automjete janë thuajse të njëkohëshme. Përdorimi i makinerive mund të alternohet sipas programit të punës për zbatimin e kontratës.

Gjithashtu per perdorimin e kamioncinave është kërkuar **2 (dy) shofere**. Ky numër shofresh është kërkuar minimal në raport me nevojat, duke patur për qëllim rritjen e pjesëmarrjes

Ofertuesi për stafin e mësipërm duhet të paraqesë:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.
- c) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë emer/mbiemer, profil i punës, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.
- d) Punëtorët e mësipërm te figurojne ne listëpagesa **për muajin e fundit** nga data e hapjes së ofertave.

***Në rastin kur punonjësit Shoferë, Automakinistë janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë).***

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt.

*Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.*

*Numri dhe kualifikimi i punonjësve të paraqitur në këtë ofertë është përcaktuar në përputhje me mjetet dhe makineritë e deklaruarat për realizimin e kontratës. Çdo mjet i parashikuar shoqërohet*

me personelin përkatës teknik të nevojshëm për operimin e tij, duke garantuar funksionim të pandërprerë dhe efikas gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve.

Konkretisht, numri i shoferëve, eskavatoristëve, buldozeristit dhe automakinistëve është dimensionuar mbi bazën e numrit dhe llojit të makinerive të angazhuara, për të përballuar ngarkesën e punës dhe çdo situatë operative.

Kjo qasje garanton një shpërndarje optimale të burimeve njerëzore në raport me kapacitetet teknike, duke rritur sigurinë, cilësinë dhe efikasitetin e realizimit të punimeve në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Në tërësi, këto kërkesa për staf minimal janë të justifikuara nga: Volumi dhe dinamika e punimeve; Nevoja për paralelizëm në procese; Respektimi i afateve kontraktuale; Garantimi i sigurisë në kantier; Cilësia e zbatimit sipas standardeve të ndërtimit të rrugëve.

Prandaj, vendosja e këtyre kriterëve në dokumentet e tenderit synon të sigurojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të kenë kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin me sukses të projektit.

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësi	Sasi/copë	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Kamion me vinc kapacitet mbajtës 3.5 - 7 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Autovinç	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Vinc Karrel	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Gjenerator / Motogjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Betoniere kantieri	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Pompë Suvatimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Elektrobetoniere/Betoniere	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Depozite uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Vibrator betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Matrapik	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Elektrosaldatrice/Motosaldatrice/Saldatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera

14	Vinç me kosh me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Skeleri	m <sup>2</sup>	100	Në pronësi ose me qera

**Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:**

*a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), certifikatë për transport mallrash.*

*b) Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash.*

*c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.*

*d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku për mjetet me targa të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

*e) Për autobitumatriçe të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshme.*

*f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklarara sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.*

*g) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryej verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Nëpërmjet këtyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.*

*Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM nr. 216, date 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim". Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se*

*punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).*

**Argumentim Teknik:** *Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim .” referuar volumeve dhe llojit të punimeve të preventivit si dhe nisur nga natyra dhe shperndarja e objektit në disa sektore larg njëri tjetrit Konkretisht:*

- **Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit, këto mjete janë për transporte të distancave ndërmjetëse më të afërta që të arrihet një ekonomizim i distancës me ngarkesën që mbajnë dhe me kostot e automjetit.

- **Kamioncinë me kapacitet deri në -3.5 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit të materialeve të këtij tonazhi kryesisht brenda dhe jashtë

- **Kamion me vinc kapacitet mbajtes 3.5 - 7 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat për transportin e materialeve të ndërtimit brenda kantierit sipas nevojave të punës dhe sasisë, tipologjitë e materialeve që do të transportohen nevojiten kamionçina me vinc me kapacitet mbajtës 3.5-7 Ton. Ky numër është minimumi i nevojshëm në raport me vëllimin e materialeve

- **Autovinç** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat për transportin vertikal/ngritjen e materialeve të rënda të ndërtimit brenda kantierit nevojitet minimalisht një autovinç. Punimet e parashikuara në projekt - preventivin e zbatimt.

- **Pompë Suvatimi** Referua preventivit, përdorimi i pompës së suvatimit është i domosdoshëm sepse rrit shpejtësinë e punës deri në 5 herë në krahasim me metodën manuale, duke bërë të mundur realizimin e deri në 200 metrave katrorë suva në ditë nga e njëjta skuadër. Përveç shpejtësisë, makineria siguron një përzierje plotësisht homogjene të mortajës që parandalon plasaritjet pas tharjes, ndërsa presioni i lartë gjatë hedhjes garanton një ngjitje maksimale dhe pa flluska ajri me murin. Ky proces minimizon humbjet e materialit që zakonisht bien në tokë dhe optimizon fuqinë punëtore, duke ofruar një kontroll më të rreptë të kostove dhe një realizim shumë më të shpejtë e cilësor të projektit.

- **Vinç me karrel** shërben për transportin vertikal/ngritjen e materialeve të ndërtimit brenda kantierit nevojitet minimalisht një vinç karel. Punimet e parashikuara në projekt - preventivin e zbatimt dhe në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023

- **Vinç me kosh me goma**, i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat për transportin vertikal/ngritjen e materialeve të lehta të ndërtimit brenda dhe në fasadë nevojitet minimalisht një vinç me kosh dhe me goma për mos dëmtimin e sipërfaqeve të shtruara përreth objektit.

- **Pajisjet e tjera si betonierë, skeleri, depozitë uji, betoforma, matrapik, vibrator betoni, gjenerator, saldatriç**, janë mjete dhe pajisje të lidhura ngushtë me zërat e preventivit.

***Këto makineri janë të justifikuara sepse: mbulojnë të gjitha fazat e ndërtimit të objektit, mundësojnë punë të njëkohshme në disa fronte; garantojnë cilësi sipas standardeve teknike; ndihmojnë në përmbushjen e afateve kontraktuale dhe rrisin efikasitetin në kantier.***

**2.3.11** Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

**\* ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë)**

**\* ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)**

**\* ISO 45001:2018 /45001-2023, (Sistem i Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë)**

*Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar.*

*Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë ISO duhet plotësuar nga operatorët ekonomik, sipas natyrës së punëve që marrin përsipër.*

***Shënim: Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.***

**Argumentim:** *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i publikuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

**ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë)** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e

veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

Në ndërtimin e rrugëve, ku cilësia e shtresave (bazë, nënbazë, asfalt) është kritike për jetëgjatësinë e investimit, ISO 9001 minimizon rrezikun e defekteve dhe punimeve jashtë standardit.

**ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet **mjedisore** ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

**ISO 45001:2018 /45001-2023, (Sistem i Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë)** është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 /45001-2023, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Punimet e ndërtimit të rrugëve përfshijnë rreziqe të larta (makineri të rënda, trafik, punë në terren). Kjo certifikatë siguron që: të identifikohen dhe menaxhohen rreziqet në kantier, mbrohen punonjësit dhe palët e treta, reduktohen aksidentet dhe incidentet në punë.

**2.3.12** Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Materiale elektrike
- Materialet hidraulike
- Materialet e sistemit të mbrojtjes kundra zjarrit (MNZ)
- Materiale të sistemit të ngrohjes HVAC
- Materiale hidroizoluese, llac, fino, kolle
- Pajisje hidrosanitare
- Pllaka, Parket,
- Bojra
- Mobilim (karrige dhe perde fondale rezistente ndaj zjarrit)

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë/autorizim) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe proporcion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë e dhe natyrën e punimeve, zërat të cilat kanë volum maksimal të lëndës bazë dhe materialeve të kryerjes së punimeve. Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit të cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet shërbim me "mall" sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 40 pika 6 germa b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

**2.3.13** Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Grafikon e punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin **15 pika 3/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: "**a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikon e zbatimit;**", si dhe Neni 39, pika 3 e kesaj VKM-je.

**2.3.14** Cdo ofertues duhet të paraqesë **Planorganizimin dhe Planin e Sigurisë në Kantier** për punimet në objekt.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 39, pika 3 dhe pika 8.

Kërkesa që çdo ofertues të paraqesë **Planorganizimin dhe Planin e Sigurisë në Kantier** është thelbësore për një projekt ndërtimi rrugor, pasi garanton organizim të mirë të punimeve, përdorim efikas të burimeve dhe respektim të afateve.

*Njëkohësisht, Plani i Sigurisë siguron mbrojtjen e punëtorëve dhe publikut, parandalon aksidentet dhe garanton zbatimin e standardeve ligjore gjatë punimeve në rrugë.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Argumentimi:** *Kjo procedure karakterizohet nga një vlerë e lartë investimi dhe një rëndësi e veçantë për interesin publik, vlerësohet thelbësore që operatorët ekonomikë ofertues të disponojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të verifikueshme kriteret kryesore të kualifikimit, konkretisht përvojën në punë të ngjashme, stafin drejtues teknik dhe licencën profesionale.*

*Në rastet kur operatori ekonomik nuk i zotëron vetë këto kapacitete dhe mbështetet në subjekte të tjera, krijohet një ekspozim i konsiderueshëm ndaj riskut të mosrealizimit të kontratës. Kjo për faktin se elementet e sipërpërmendura nuk janë thjesht kritere formale, por përbëjnë bazën funksionale dhe operacionale për zbatimin me sukses të investimit.*

*Mungesa e përvojës së drejtpërdrejtë në punë të ngjashme rrit ndjeshëm probabilitetin e gabimeve në planifikim, në menaxhimin e proceseve dhe në përballimin e situatave të paparashikuara gjatë zbatimit. Në projekte me vlerë të lartë (siç është procedura objekt prokurimi), këto mangësi mund të përkthehen në vonesa të konsiderueshme, rritje të kostove dhe ulje të cilësisë së punimeve apo shërbimeve.*

*Njëkohësisht, mosdisponimi real i stafit drejtues teknik krijon pasiguri mbi aftësinë e operatorit për të menaxhuar kontratën në mënyrë efektive. Nëse ky staf nuk është pjesë organike e operatorit, ekziston rreziku që ai të mos jetë i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme ose të tërhiqet gjatë zbatimit, duke sjellë ndërprerje, çorganizim dhe dobësim të kontrollit teknik të projektit.*

*Po ashtu, mungesa e licencës profesionale në mënyrë të drejtpërdrejtë nga operatori përbën një risk të qartë ligjor dhe operacional. Kjo situatë mund të çojë në pengesa administrative, pezullim të punimeve apo edhe pavlefshmëri të veprimeve të kryera, me pasoja të drejtpërdrejta në ecurinë e investimit.*

**Duke pasur parasysh vlerën e lartë të kontratës, çdo dështim apo mosrealizim i saj nuk sjell vetëm pasoja për autoritetin kontraktor, por edhe dëm ekonomik dhe social më të gjerë, përfshirë bllokimin e fondeve publike, mosrealizimin e objektivave të projektit.**

*Në këtë këndvështrim, lejimi i mbështetjes në subjekte të tjera për këto kritere thelbësore rrit ndjeshëm riskun e transferimit formal të kapaciteteve pa garanci reale për disponueshmërinë dhe përdorimin e tyre efektiv gjatë zbatimit të kontratës.*

*Për rrjedhojë, për një procedurë me këtë nivel investimi dhe rëndësie, vlerësohet e domosdoshme që operatorët ekonomikë të provojnë kapacitetet e tyre në mënyrë të pavarur dhe të drejtpërdrejtë, duke minimizuar rreziqet e mosrealizimit dhe duke garantuar një përdorim efikas dhe të sigurt të fondeve publike.*

## **I. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punët objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike, janë hartuar në përputhje me legjislacionin përkatës për ndërtimet civile dhe infrastrukturore dhe kanë për qëllim të sigurojnë cilësi të qëndrueshme, funksionalitet afatgjatë dhe siguri teknike të punimeve të parashikuara në rikonstruksionin e rrugëve në njësitë administrative. Për shkak të veçorive të terrenit dhe kushteve klimatike të zonës, janë përfshirë elementë të detajuar. Këto specifikime janë proporcionale me objektin e kontratës, të zbatueshme në praktikë dhe janë hartuar me kujdes për të parandaluar keqzbatimin teknik, për të garantuar jetëgjatësinë e rrugës dhe për të krijuar kushte të sigurta qarkullimi për banorët e zonës.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**